



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”.
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar.
3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH” të ndryshuar”.
4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

Genci Terpo - kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Arben Isaraj – zëvendësministër në Ministrinë e Drejtësisë.

Katrin Treska – drejtoreshë në Drejtorinë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Si pikë të parë në rendin e ditës kemi: projektligjin “Për disa ndryshime në Kodin e Familjes”, të paraqitur nga qeveria dhe e iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, si dhe projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit””.

Meqenëse të dyja projektet janë të iniciuara nga Ministria e Drejtësisë, i pranishëm në këtë mbledhje janë: Arben Isaraj, zëvendësministër, së bashku me zonjën Treska dhe zotin Terpo, kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Fillojmë me një paraqitje të projekteve. Do t’i përfshini të dyja në një paraqitje? Dakord.
Zoti Isaraj, urdhëroni!

Arben Isaraj - Faleminderit!

Të dyja projektet janë të integruara me njëra-tjetrën, ndaj, po bëj një paraqitje të përbashkët, duke e nisur me ndryshimet në procedurat e birësimit dhe Komiteti Shqiptar i Birësimit, pasi nga këto ndryshime vijnë edhe pasojat që do të ndodhin në Kodin e Familjes.

Propozimet “Për ndryshimet në ligjin nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komiteti Shqiptar i Birësimit””, të shoqëruara këto edhe me ndryshimet në Kodin e Familjes, lidhen me amendimin e dispozitave që prekin drejtpërdrejt çështjen e birësimit dhe janë rrjedhojë e një procesi të gjatë konsultimi që nga nëntori vitit 2013 me një grup ekspertësh, që kanë dhënë kontribut të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ndër vite dhe veçanërisht, është për t’u theksuar, me ndihmën e madhe që është dhënë nga ekipi i ambasadës së SHBA-së, ekspertët e misionit OBDAT në Shqipëri, si edhe me ndikime të ambasadorëve të SHBA-së në Shqipëri.

Ky propozim, së pari, vjen si produkt i nismës së komitetit, i nenit 5. Është një iniciativë e përbashkët e ambasadave të SHBA-së dhe të Austrisë në Tiranë.

Objektivi kryesor i saj është përmirësimi i situatës ligjore për trajtimin e atyre fëmijëve, prindërve biologjik që nuk janë në gjendje të kujdesen dhe të vendosin për lënien e tyre në birësim.

Gjithashtu, duhet theksuar se për këtë proces janë angazhuar edhe përfaqësuesit e Këshillit Drejtues të Komitetit Shqiptar të Birësimit, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, përveç bashkëpunimit që kanë pasur edhe në vazhdimësi në takimet konsultative me agjencitë

ndërmjetësuese në fushën e birësimit, me institucionet e shoqërisë civile, me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe me institucionet e përkujdesjes sociale.

Gjithashtu, dua të theksoj se ky projektligj është i parashikuar në programin analitik të projekt-akteve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2015.

Këto propozime, të nderuar deputetë, për ndryshimet ligjore me miratimin e tyre, do të shërbenin në ngritjen e nivelit të shërbimit të institucionit të Komitetit Shqiptar të Birësimit për zbatimin e ligjit, duke sjellë instrumente më të plota garancie që do të siguronin mbrojtjen e interesave më të larta të fëmijëve të braktisur, për të gjetur familje sa më të përshtatshme dhe në kohë reale duke shmangur institucionalizimin e tyre.

Iniciativa jonë është në përputhje me ligjet. Këto i kemi të përshkruara qartësisht në relacion, por duhet të theksojmë se ky projektligj nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar, ndaj nuk ka edhe një vlerësim, po ta vini re, të shkallës së përafrimit me këtë legjislacion.

Të dyja projektet shkojnë drejt 5 neneve. Te projektligji i parë, neni 1 parashikon ndryshimet në nenin 10 të ligjit të birësimeve në aspektin e kapaciteteve tashmë për kryetarin e Komitetit Shqiptar të Birësimeve. Ju e shikoni se ka një ndërhyrje në lidhje me përvojën e punës së tij dhe ku ngrihet kjo përvojë e punës. Gjithashtu, ka edhe disa kërkesa, që lidhen me rritjen e standardit në drejtimin e institucionit të Komitetit Shqiptar të Birësimit.

Pa u zgjatur në nenin 2 të projektligjit kemi ndryshime në nenin 18 të ligjit, duke shtuar një pikë të re, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit për nivelin arsimor të detyrueshëm për aplikantin birësues. Kjo është risi që lidhet me prindërit e ardhshëm të fëmijëve që birësohen, gjë që nuk ishte më parë.

Së treti, në nenin 3 të projektligjit parashikohen ndryshime të nenit 23 të ligjit dhe duhet theksuar se këto ndryshime reflektojnë uljen e kohës së pritjes së fëmijëve për kontingjent birësimi jashtë shtetit shqiptar. Kjo do të shkonte në përputhje, prandaj po i lidhim të dyja edhe me propozimin për ndryshimet, që kemi në nenin 257 të Kodit të Familjes, ku parashikohet të realizohet i njëjti ndryshim. Kjo kohë, që deri më sot ka qenë 6 muaj pritjeje, në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimit të fëmijëve, të cilëve u propozohet çifteve shqiptare dhe kur nuk arrihet birësimi në Shqipëri, u propozohet çifteve të huaja.

Komiteti Shqiptar i Birësimit, duke synuar interesin më të lartë të fëmijëve jetimë, gjë për të cilën edhe shoqëria shqiptare është shumë e interesuar për gjetjen e një familjeje të përshtatshme, për shkak të nevojave që kanë këta fëmijë dhe cilësi të veçanta që ka gjithsecili, nga analiza e punës që ka bërë deri më sot gjykon se procedura e birësimit për fëmijët, që u përkasin sidomos komuniteteve rome apo origjinës etnike të ndryshme (ne kemi pasur raste edhe të komitetit egjiptian nga ajo shqiptare), ka fëmijë që janë me probleme shëndetësore me ose pa rrezik për jetën, ka edhe fëmijë të mëdhenj në moshë, që nuk pranohen për birësim nga aplikantë shqiptarë me gjithë përpjekjet që bëhen në vijim nga ana e Komitetit Shqiptar të Birësimit për gjetjen e familjeve birësuese.

Për rrjedhojë, pritja në lista për një periudhë 6-mujore është një zgjatje që nuk ka efekt dhe kjo rezulton nga praktika dhe nga vlerësimi i ekspertëve për birësimin e fëmijëve në Shqipëri, dhe për këtë ne mendojmë që kjo kohë të ulet nga 6 muaj në 3 muaj. Në këtë formë do të minimizohej risku i institucionalizimit të mëtejshëm të fëmijëve, të cilët në pamundësi të gjetjes së një familjeje brenda vendit do t'u propozohej një familjeje nëpërmjet birësimit ndërvendas.

Gjithashtu, neni 4 i projektligjit parashikon një shtesë në nenin 24, lidhur me çështjen e dhënies me afat të vendimit të Këshillit të Drejtues të Komitetit Shqiptar të Birësimit. Ajo ishte një normë, pak a shumë, që varionte nga 1 deri në 3 vjet, duke i lënë mundësi zgjatjes së tejskajshme. Tashmë e detyrojmë edhe komitetin, por edhe institucionet, që lidhen me të në këtë proces, të parashikohet një afat fiks dhe ky vendoset të jetë 2-vjeçar.

Është për t'u theksuar se të dyja projektligjet nuk paraqesin asnjë efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit. Përkundrazi, i shërbejnë asaj që është primare, trajtimit të fëmijëve të mitur në Republikën e Shqipërisë dhe sidomos atyre fëmijëve, që janë dënuar nga prindërit biologjikë.

Nuk dua të zgjatem pasi relacionet janë të qarta në bazë të kërkesave të Kushtetutës dhe ligjit. Ne jemi të hapur për t'iu përgjigjur çdo interesimi tuaj ligjor dhe teknik, në lidhje me dy projekt-aktet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Do të vazhdojmë me paraqitjen e relacionit për projektligjin e parë, Kodi i Familjes.

Paraprakisht, po bëj me dije se ne jemi komisioni përgjegjës dhe duke qenë komision përgjegjës jemi të detyruar të presim edhe komisionet, që janë për dhënie mendimi, të cilat nuk i kanë shqyrtuar ende.

Gjithashtu, edhe me kërkesë të komisioneve të tjera, por edhe me propozimin e dy relatorëve, me miratimin e tyre, është rënë dakord të ketë një seancë dëgjimore meqenëse edhe komisionet e tjera kanë kërkuar seancë dëgjimore me grupet e interesit.

Së treti, UNICEF, që është një organizatë shumë e rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijëve, ka kërkuar një javë kohë për t'u shprehur në lidhje me përmbajtjen e këtyre dy projektligjeve.

Zonja Caka, urdhëroni!

Silva Caka – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, meqenëse zoti Isaraj bëri një prezantim të të dy projektakteve, unë do të përpiqem shkurtimisht të distancoj Kodin e Familjes nga projekt-akti tjetër, me qëllim që të jemi sa më të qartë.

Kodi i Familjes ka ardhur si paketë bashkë me projektligjin “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimit”. Ndryshimet në Kodin e Familjes kanë prekur vetëm institutin e deklarimit të braktisjes, pra, nenin 250 të këtij kodi dhe afatet për birësimet ndërvendas, që është neni 257 i kodit.

Sipas relacionit, ky projektligj synon të lehtësojë në mënyrë të menjëhershme birësimin e disa kategorive të fëmijëve, konkretisht të fëmijëve të braktisur që nga lindja dhe të fëmijëve të braktisur me qëllimin për t'u dhënë për birësim.

Deklarimi i braktisjes ka prekur fëmijët e këtyre kategorive që do të përmend më poshtë:

Së pari, fëmijët e lindur në institucione shtetërore, të cilët braktisen menjëherë pas lindjes me një deklaratë të prindit ose të prindërve, që lejon birësimin dhe mund të jenë fëmijë nga martesë ose jashtë martesë.

Së dyti, fëmijë që lihen nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes sociale me një deklaratë të prindërve që lejojnë birësimin.

Së treti, fëmijë që braktisen pranë institucioneve të mësipërme, pa u lënë një deklaratë që lejon birësimin.

Së katërti, fëmijë të gjetur për të cilët nuk u njihen prindërit ose kujdestarët.

Së pesti, fëmijë që lihen përkohësisht nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjeve sociale, për shkak të pamundësisë për t'u përkujdesur për ta, pasi me kalimin e kohës dhe me ndryshimin e situatës së prindërve mund të ndodhë që të plotësohen kushtet ligjore për deklarimin e braktisjes.

Secila nga kategoritë paraqet problematika dhe nevoja specifike. Kështu që ligji duhet të bëjë dallimin midis kushteve dhe afateve që zbatohen për deklarimin e braktisjes dhe për rrjedhojë edhe për dhënien e vlerësimit të fëmijëve që i përkasin secilës kategori.

Në veçanti, dua të theksoj kategorinë a dhe b, të cilat kanë një specifike pasi braktisen me vullnetin e shprehur të prindërve për t'u dhënë për birësim. Pra, situata paraqitet më e qartë, ku edhe për këto kategori vullneti i prindërve që ata të jepen për birësim është më i qartë. Prandaj ne kemi menduar që edhe koha e pritjes duhet të jetë më e shkurtër dhe kërkimet për familjen biologjike të jenë më të pakta.

Ndryshimet konsistojnë si më poshtë:

Së pari, propozohet të përcaktohet momenti i fillimit të afatit të pritjes për deklarimin e braktisjes. Për këtë arsye propozohet që paragrafi i dytë i nenit 250 të Kodit të Familjes të ndryshojë si më poshtë: “Kur i mituri është gjetur i braktisur ose kur i mituri është lënë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes sociale, përfshirë spitalet, nëpërmjet një deklarimi me shkrim të prindërve biologjikë për dhënien e tij për birësim, afati prej një viti kufizohet në 3 muaj dhe fillon që nga momenti i gjetjes ose lënies së të miturit”.

Së dyti, është propozuar që në rastet kur prindi ose prindërit kanë nënshkruar një deklaratë për braktisjen e fëmijës dhe kanë shprehur vullnetin që fëmija të jepet për birësim, nuk është e nevojshme të kryhen ende përpjekje për t'i kontaktuar prindërit ose për ta bashkuar fëmijën me familjen biologjike. Si rrjedhojë, propozohet të shtohet kjo fjali në fund të paragrafit të katërt të nenit 250: “të tilla përpjekje nuk janë të nevojshme në rastin kur fëmija është lënë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes sociale përfshirë spitalet nëpërmjet një deklarimi me shkrim të prindërve biologjikë për dhënien e tij për birësim”.

Së treti, është propozuar të saktësohet gjuha e përdorur në paragrafin e fundit të nenit 250, për të lejuar ndërprerjen e afatit vetëm kur anëtarët e familjes bëjnë kërkesa që kanë pasoja ligjore dhe që janë pranuar në rrugë gjyqësore. Konkretisht, shtesa do të jetë: “braktisja nuk deklarohet kur një gjykatë tjetër ka pranuar kërkesën e një të afërmi të fëmijës përcaktimin si kujdestar të tij. Nëse gjykimi i një kërkesë të tillë nuk ka përfunduar, atëherë gjykata pezullon shqyrtimin e kërkesës për deklarimin e braktisjes deri në përfundimin e tij”.

Për shkak të rëndësisë që paraqet kjo nismë ligjore bashkë me nismën tjetër dhe në vijim të praktikës më të mirë që, tashmë, Komisioni i Ligjeve e ka konsoliduar, që është ai i konsultimit publik, projektligji është dërguar për mendim organizatave të shoqërisë civile grupeve të interesit,

pedagogëve të fushës së të drejtës familjare dhe institucioneve, që kanë në fokus veprimtarisë së tyre, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si: Save the Children, UNICEF, Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, World Vision etj. dhe disa prej tyre kanë sjellë një mendim të konsoliduar, ku do të theksoja: Save the Children ka sjellë mendime, vërejtje dhe sugjerimet e saj, të cilat janë reflektuar në relacion. Njëkohësisht, edhe në këndvështrimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit ndryshimet në Kodin e Familjes janë konsideruar sikur lehtësojnë birësimin e kategorive të fëmijëve të braktisur dhe rregullojnë problematikat e praktikës gjyqësore. Ashtu siç e përmendi edhe kryetari i komisionit, do të presim edhe mendimin e zyrës së UNICEF-it në Shqipëri, pasi i kanë konsideruar këto ndryshime të një rëndësie të veçantë sa kanë kërkuar edhe pak më tepër kohë shtesë.

Njëkohësisht, në relacion kemi edhe standardet ndërkombëtare për birësimin e fëmijëve, por meqenëse deputetët e kanë relacionin përpara për të shkurtuar kohën, thjesht po i përmend në mënyrë nominale:

Kemi Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, konkretisht nenin 21; kemi nenin 4 të Konventës së Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin për Birësimet Jashtë Vendi; neni 10 i Konventës Europiane për adoptimin e fëmijëve të vitit 2008.

Gjithashtu, kemi edhe disa çështje të tjera, që janë për t'u diskutuar. Ne kemi ngritur 3 çështje kryesore për diskutim. Janë edhe disa çështje të tjera.

Së pari, në pikën 1 të nenit 1 përcaktohet momenti i fillimit të afatit të pritjes për deklarimin e braktisjes për atë kategori fëmijësh, të cilët braktisen me vullnetin e shprehur të prindërve, me synimin për të shkurtuar procedurat e zgjatura të birësimit.

Në sugjerimin e organizatës Save the Children theksohet se zgjatja e këtyre procedurave të birësimit në të shumtën e rasteve nuk krijohet nga afati ligjor i vendosur në ligj apo në kod, por nga mënyra si është zbatuar ligji nga institucionet e përkujdesjes dhe nga gjykata.

Konkretisht, sipas opinionit të kësaj organizate ka disa shkaqe që influencojnë zgjatjen e kohës deri në regjistrimin e fëmijës në listën e Komitetit të Birësimit dhe janë vërejtur 3 shkaqe kryesore, që janë: së pari, institucionet e përkujdesjes të nisin procedurat e deklarimit të braktisjes jashtë afateve të përcaktuara

Së dyti, Kodi i Familjes nuk përcakton afate për përfundimin e procesit të deklarimit të braktisjes në nenet 250 dhe 251. Pra, gjykata nuk ka kufizim kohor në mënyrë që gjykata t'i gjykojë këto çështje me përparësi.

Së treti, vetë institucionet nuk dërgojnë informacion për regjistrimin e fëmijës në lista menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor për deklarimin e braktisjes.

Për të rregulluar pikërisht shkurtimin e kohës së procesit të birësimit të fëmijës, Save the Children ka propozuar që në nenet 250 dhe 251 të Kodit të Familjes të rregullohen si më poshtë:

Në paragrafin e parë të nenit 250 pas fjalës “rrethit”, të shtohet fjala “brenda 30 ditëve”. Dhe në nenin 251 në fund të fjalisë së parë pas fjalës “përkujdesje” të shtohen fjalët “brenda 10 ditëve nga përmbushja e kushteve për deklarimin e fëmijës si i braktisur”.

Pika e dytë, që dua të theksoj është se në pikën 3 të nenit 3 parashikohet se procedura e braktisjes ndalon nëse fillon një proces kujdestarie nga një i afërm i fëmijës. Save the Children është shprehur se krijohet një konfuzion midis dy instituteve të së drejtës, që janë ai i birësimit dhe ai i kujdestarisë, të cilat janë krijuar për qëllime të ndryshme, pasi birësimi synon të krijojë një marrëdhënie prindër-fëmijë në mënyrë të përhershme, ndërsa kujdestaria synon të krijojë një mjedis të ngjashëm në mënyrë të përkohshme, duke e konsideruar se fëmija do të kthehet pranë familjes së origjinës, por kujdestaria të një i afërm nuk mund të jetë kusht ndalues për birësimin e mëtejshëm të tij.

Në Konventën për të Drejtat e Njeriut dhe në Konventën e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit është synuar të ruhet mundësia e rritjes së fëmijës në ambientin familjar, duke përfshirë edhe konceptin e familjes së gjerë edhe në vendin e origjinës kur kjo i shërben planit afatgjatë të rritjes së fëmijës dhe mundësisë së integritetit të tij.

Ndërkohë, Save the Children ka propozuar një tjetër ndryshim, të cilin do ta theksoj në momentin kur të vijmë në shqyrtimin nen për nen.

Pika e tretë që dua të theksoj është se në nenet 2 dhe 3 të projektligjit është parashikuar ulja e afatit nga 6 muaj në 3 muaj për lejimin e birësimit ndërvendas. Në fakt, nga analiza e akteve ndërkombëtare, neni 21 i Konventës për të Drejtat Fëmijës dhe neni 4 i Konventës së Hagës është vërejtur se në asnjë rast kriteret thelbësore për lejimin e birësimit ndërvendas nuk lidhen me vendosjen e ndonjë afati kohor ashtu siç është propozuar.

Nga sugjerimet e Save the Children duhet të mbahet në konsideratë që legjislacioni të krijojë fleksibilitetin e duhur për të lejuar birësimin ndërvendas jashtë kornizave të një afati të përcaktuar formal kur e kërkon interesi i fëmijës.

Për shembull, në rastin kur fëmijët janë të sëmurë dhe kurimi i tyre brenda vendit është i pamundur dhe po kështu kur përpjekjet për t'u birësuar nga prindër shqiptarë, që jetojnë jashtë shtetit, kanë qenë të pasuksesshme, Save the Children sugjeron që afati të mos ndryshohet, por të jetë i një natyre ndaluese. Pra, në qoftë se kalon afati 3 ose 6 muaj, fëmija mund të konsiderohet ligjërisht i disponueshëm për birësim ndërvendas e megjithatë për këtë fëmijë mund të vazhdohet të bëhet një përpjekje për birësim në Shqipëri.

Gjithashtu, disa çështje të tjera, që duhet të shqyrtohen, janë edhe birësimi i fëmijëve mbi një moshë të caktuar, që nuk janë foshnje. Për kategorinë e fëmijëve që lihen në institucione, ose njëri nga të dy prindërit, të cilët nuk e shikojnë vendosjen në institucion si masë të përkohshme, por si një mënyrë për të zbutur varfërinë, shteti duhet të bëjë përpjekjet e tij për ta ndihmuar familjen që të zbusë varfërinë dhe ta sjellë fëmijën në gjirin e saj për rritje dhe edukim.

Për kategorinë e fëmijëve që lihen në institucione në braktisje të heshtur, pra, prindërit nuk marrin përgjegjësinë e duhur për të prindëruar, propozohet të ulet afati 1-vjeçar, i parashikuar në nenin 251, paragrafi i parë i Kodit të Familjes, për të lejuar krijimin apo mbajtjen e një marrëdhënie prindër-fëmijë dhe të vendosin një afat maksimal të lënies së fëmijës në institucion me kalimin e të cilit fëmija mund të shpallet i braktisur dhe si i tillë mund të futet në listat për birësim të komitetit.

Për kategorinë e fëmijëve që vijnë nga situata neglizhimi, braktisjeje, dhune, shfrytëzimi apo abuzimi dhe kur përgjegjësia prindërore nuk është ushtruar në mënyrën e duhur, ndërhyrja e shtetit duhet të jetë e drejtpërdrejtë për evidentimin e mundësisë reale që kanë për t'u kthyer në familjen e origjinës dhe për të mos u ekspozuar më ndaj dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe shfrytëzimit, dhe nëse rezulton se familja nuk e ofron këtë garanci, atëherë ata shpallen si fëmijë të braktisur dhe regjistrohen në listat e komitetit.

Së dyti, sugjerohet që në Kodin e Familjes dhe në ligjin e birësimit të ketë një përcaktim të qartë të vazhdimësisë së marrëdhënieve familjare mes motrave dhe vëllezërve.

Së treti, sugjerohet të përcaktohet këshillimi paraprak i prindërve përpara dhënies së pëlqimit për birësim. Për këtë arsye, propozohet të ndryshohet paragrafi i parë i nenit 246 dhe paragrafi i parë i neni 247 të Kodit të Familjes me këto përmbajtje:

Në nenin 246, thuhet: “Për vlerësimin e fëmijës kërkohet pëlqimi i të dy prindërve, i cili mund të jepet vetëm pasi prindërit janë informuar dhe këshilluar për efektet ligjore të birësimit dhe për pasojat psikoemocinale të tij”, dhe në nenin 247 thuhet: “Pëlqimi për birësimin jepet përpara

gjykatës kompetente, e cila përpara se ta administrojë pëlqimin, verifikon nëse prindërit janë këshilluar paraprakisht në lidhje me efektet e këtij birësimi. Nëse këshillimi rezulton i mangët, gjykata pezullon gjykimin dhe cakton një afat për këshillimin e prindërve deri në seancën tjetër gjyqësore”

Së katërti, duhet të shihet mundësia e konsiderimit me prioritet të kujdestarit të një fëmije, si aplikant birësues, nëse ekzistojnë kushtet e përgjithshme, që e lejojnë birësimin e fëmijës.

Siç e përmenda edhe në fillim n,e do të presim ende për të shqyrtuar këtë projektligj nen për nen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Caka!

Meqenëse i përmbledhëm të dyja projektet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, bëjmë edhe paraqitjen shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni, ju, si relatores, ndonjë gjë më shumë?

Dakord, që t’i përmbledhim, meqenëse ramë dakord dhe meqenëse janë pyetje me natyrë të njëjta.

Po,

Anila Agalliu – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Isaraj i pasqyroj shumë qartë ndryshimet e propozuara në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin numër 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”, të ndryshuar””, por unë do të përqendrohem vetëm në disa çështje për diskutim këtu në komision.

Nga studimi i projektligjit dhe i relacionit shoqërues të tij, vlerësoj se duhen evidentuar dhe të shtrohen për diskutim me anëtarët e tjerë të komisionit disa çështje të rëndësishme, si më poshtë:

Neni 1 i projektligjit parashikon ndryshimin e pikës 2 të nenit 10 të ligjit në fuqi, i cili parashikon kriteret e emërimit të kryetarit të komitetit. Propozohet që kryetari i komitetit të birësimit të ketë arsimin e lartë në shkencë juridike, duke përjashtuar shkencat sociale dhe pedagogjinë. Ky ndryshim, sipas relacionit, justifikohet me nevojën për një njohje të thellë të

akteve ligjore e nënligjore dhe formimi i duhur në fushën e drejtësisë, do të garantonte zbatimin me përpikëri të tyre.

Duhet të mbahet në konsideratë, që kryetari është titullari i Institucionit të Komitetit të Birësimit, i cili ka në varësi të tij një administratë në përbërje të të cilës janë këshilltarët apo shërbimet juridike, që mund të garantojnë njohjen dhe zbatimin e akteve ligjore. Nga ana tjetër, birësimi më tepër se një institut i së drejtës, është një proces social dhe human, që sjell efekte me natyrë përfundimtare në jetën e fëmijës. E parë në këtë këndvështrim, diploma në shkenca sociale do të ishte një kriter më se i pranueshëm.

Së dyti, në nenin 2 të projektligjit parashikohet të shtohet në dokumentacionin e aplikantit birësues edhe dokumentacioni i përfundimit të nivelit arsimor të detyrueshëm të aplikantit birësues, si kusht për të aplikuar dhe për t'u kualifikuar si prind birësues i një fëmije.

Nga analiza e akteve ndërkombëtare, neni 10 i Konventës Europiane për Adoptimin e Fëmijëve, vihet re se në asnjë prej tyre nuk ekziston një përcaktim i tillë si kriter kualifikues, por rëndësi i kushtohet personalitetit, shëndetit, ambientit social dhe, për më tepër, aftësisë për të rritur një fëmijë.

Nga sugjerimet e dhëna nga organizata Save the Children, vihet re se arsimimi i prindit adoptues mund të verifikojë dhe të analizohet në kuadër të kryerjes së studimit për aplikantin birësues nga Komiteti i Birësimit, si një nga elementet për t'u konsideruar në lidhje me përshtatshmërinë e prindit birësues për fëmijën, neni 3 i ligjit “Për birësimin” dhe paragrafi i parë i nenit 253 të Kodit të Familjes.

Save the Children thekson se prindërit birësues shqiptarë mund të jenë me arsim të ndryshëm. Në ndryshimet që propozohen nuk tregohet situata kur njëri prind e ka bërë arsimin e detyrueshëm dhe tjetri jo. Një rast i tillë do të detyronte vetëm njërin prind, atë që plotëson kriterin e arsimit të detyrueshëm, të ishte aplikant për birësim dhe jo tjetrin.

Në nenin 4 parashikohet ulja e afatit nga 6-mujor në 3-mujor për lejimin e birësimit ndërvendas. Nga analiza e akteve ndërkombëtare, në nenin 21 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe në nenin 4 të Konventës së Hagës vihet re se në asnjë rast kriteret thelbësore për lejimin e birësimit ndërvendas nuk lidhet me vendosjen e ndonjë afati kohor, ashtu siç propozohet. Nga sugjerimet e Save the Children, duhet të mbahet në konsideratë, që legjislacioni të krijojë fleksibilitetin e duhur për të lejuar birësimin ndërvendas, jashtë kornizave të një afati të përcaktuar formal, kur e kërkon interesi i fëmijës.

Save the Children sugjeron që afati të mos ndryshohet, por të mos jetë i një natyre ndaluese, pra në qoftë se kalon afati 3 ose 6-mujor, fëmija mund të konsiderohet ligjërisht i disponueshëm për birësim ndërvendas. Megjithatë, për këtë fëmijë, mund të vazhdojnë të bëhen përpjekje për birësim në Shqipëri, pra kalimi i një afati të caktuar nuk duhet interpretuar sikur e bën një fëmijë të padisponueshëm për t'u birësuar brenda vendit.

Nga ana tjetër, në mendimin e Save the Children theksohet se duhet mbajtur në konsideratë që birësimi i fëmijëve në një moshë më të madhe është më i vështirë. Për këtë kategori, afatet e birësimit vendas të jenë të shkurtra dhe të mundshme për t'u birësuar edhe jashtë vendit. Për këtë arsye, propozohet që ndryshimet e propozuara për uljen e afatit nga 6 në 3 muaj, të jenë të aplikueshme për fëmijët mbi 5 vjeç, të cilët regjistrohen në listat e komitetit të birësimit. Ndërsa te neni 4 i projektligjit, nga pikëpamja e teknikës legjislative, ka nevojë të riformulohet më qartë dhe të jetë një paragraf më vete dhe jo si pikë “c”, e cila nga mënyra se si propozohet nënkupton sikur është një nga masat që ndërmerr komiteti drejtues. Faleminderit!

Silva Caka – Zoti kryetar, kam vetëm diçka.

Të gjithë deputetët kanë përpara edhe një kuadër krahasimor të këtyre dy legjislacioneve me të gjitha vendet e rajonit, me Kroacinë, me Malin e Zi, me Maqedoninë, kështu që do të doja t'i hidhni një sy për të parë se si janë zhvilluar këto ndryshime në Kodin e Familjes dhe në projektaktin tjetër. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të ruaj pyetjet e veçanta, meqenëse do të ketë një seancë dëgjimore me të gjitha organizatat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Jemi në pritje edhe të opinioneve të tjera me shkrim, që do të sjellë profesorati, por edhe një pjesë tjetër e organizatave ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.

Unë kam një pyetje në lidhje me relacionin që shoqëron ligjin, konkretisht ligjin “Për procedurat e birësimit” dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit.

Në relacion thuhet se ky propozim vjen si produkt i nismës së komitetit, i nenit 5. A mund të na thoni diçka më shumë për këtë komitet. Është komitet, i cili operon vetëm në Shqipëri, apo është një komitet i nenit 5, nuk e kuptoj për cilin nen 5 është fjala? Neni 5 i ndonjë konvente, apo çfarë?

E dyta, pse ka ardhur ky propozim nga ambasadorët dhe jo nga vetë Komiteti Shqiptar i Birësimeve? Në praktikën e vet, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, ka gjetur problematika, që kanë nevojë për këto ndryshime dhe për ndryshime të tjera në ligj?

Pyetja e tretë ka të bëjë me përputhshmërinë e këtij ndryshimi, që propozohet me konventat që Shqipëria ka ratifikuar.

Zoti zëvendësministër theksoi se ky ndryshim nuk ka për qëllim të përafrojë legjislacionin me Konventën e Hagës, me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe me një sërë konventash tashmë të ratifikuara nga Shqipëria ose në të cilat Shqipëria ka aderuar. Pse bëhet ky diferencim dhe me këtë ndryshim që ne bëjmë, legjislacioni për birësimet dhe Kodi i Familjes, a është në përputhje me konventat, që tashmë janë ratifikuar nga viti 2000 e në vazhdim?

Pyetja e fundit: a është konsultuar ky ligj me organizatat, që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, qoftë vendas dhe ndërkombëtar? Pastaj, kam pyetje specifike nën për nen.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Isaraj.

Arben Isaraj – Faleminderit, për pyetjet!

Nuk dua të zgjatem, por po i përmbledh në përgjithësi, pasi kur të kalojmë nën për nen, do të kemi mundësinë t'i diskutojmë.

Në lidhje me sa parashtroi zonja deputete:

Së pari, me qëndrimet e dy relatoreve, duhet të themi që bashkëbisedimi ynë, bashkëveprimi ynë dhe bashkëpunimi me këto organizata ka qenë i vazhdueshëm. Ne kemi një listë të tërë të organizatave, ku as UNICEF-i nuk bën përjashtim, përkundrazi ka qenë prezent në nivele shumë të larta përfaqësimi. Ka dhënë, apo nuk ka dhënë objeksione në tryezë, ato gjëra janë të shkruara te ne, por ju duhet të kuptoni se në procesin e hartimit të legjislacionit, sigurisht, ne nuk nisemi vetëm nga opinionet e një subjekti, i cili është i interesuar për fushën. Ne i marrim ato në mënyrë të përbashkët dhe analizojmë se si vijnë ato në përputhje me legjislacionin tonë, gjithashtu, edhe me konventat e legjislacionit ndërkombëtar, tek të cilat ne kemi aderuar. Për sa i përket kryetarit, duhet vënë në dijeni që në Europën Perëndimore, ku duam të integrohemi, drejtuesi i këtij komiteti, pra kryetari, jo vetëm që është jurist, por në shumë raste është edhe magjistrat, pra duke marrë parasysh edhe rëndësinë e madhe të legjislacionit të fushës ku operohet.

Së dyti, kur bëhet fjalë për prindërit, që është te pjesa për ata që duhet të birësojnë, ne kemi vendosur arsimin e detyrueshëm. Nuk mendoj se duhet ta shpjegoj, sepse ai është arsim i

detyrueshëm dhe kur është i tillë, duhet ta kenë atë arsim, sepse në ligj thuhet: “... arsim i detyrueshëm” dhe duhet të jetë ai arsim i detyrueshëm, pra prindërit birësues nuk duhet të jenë fare pa arsim, me qëllim që të kuptojnë rëndësinë e asaj çka përmbledh brenda procesi i birësimit dhe marrja në rritje e një fëmije. Ky është një theksim që duhet të vinte. Ju duhet ta kuptoni se kjo vjen nga problemet që na kanë lindur në praktikë. Nuk janë probleme të shpikura rishtasi ose të prejardhura nga ndonjë konventë. Ne nuk jemi të shqetësuar nga pjesa e përafrimit, por jemi të shqetësuar vetëm nga ajo se çfarë ndodh në praktikë. Pse, pa arsye, këto procese vonohen në dëm të këtyre fëmijëve? Konsultat kanë qenë të përgjithshme. Në qoftë se doni, i listojmë të gjitha. Edhe ne i kemi ato që keni ju të shkruara, por, sigurisht, në fund kemi menduar se këto ishin ndryshimet e vlefshme. Në qoftë se ka nevojë legjislationi për ndryshime të tjera, ne jemi të hapur për t’i biseduar.

Së treti, ju përmendët edhe një listim të vendeve të rajonit dhe pyesni: pse ju jeni përtej vendeve të rajonit në fushën e birësimit? Sigurisht, gjatë këtyre vjetëve, ne kemi parë, thashë që është një kohë e gjatë, jo vetëm tani që e kemi nisur këtë gjë, por koha ka qenë edhe më parë. Edhe Ministria e Drejtësisë ka bërë vlerësime, që legjislationet rajonale për këtë proces janë shumë të ngurta dhe vetëm e pengojnë këtë proces në vend që ta lehtësojnë atë në interes të fëmijëve. Kështu që jemi munduar të kalojmë përtej legjislationit që na rrethon, duke shkuar atje ku ne detyrohemi të integrohemi. Këto janë procese teknike, që nuk kanë shumë lidhje me këtë apo me atë nen.

Gjithashtu, në lidhje me atë që na kanë detyruar ambasadorët austriakë apo të SHBA-ve, nuk e theksova në këtë mënyrë, edhe në relacion nuk është shkruar në atë mënyrë, por ata kanë qenë pjesë përbërëse e tryezave tona. Unë vetë kam qenë pjesë e dy tryezave, ku ata jepnin edhe shembujt e vetë si kishin birësuar fëmijë në jetën e tyre dhe diskutonin me ne për gjëra, të cilat janë të veçantë, pra shqetësimet që kishin lidhje me gjykatat, me vonesat e procedurave në gjykata e të tjera, gjëra të cilat ne, pothuajse, i kemi parashtruar në ndryshimet që kemi bërë.

Sigurisht jo çdo projekt është i plotë, i përfshirë, ne presim edhe sugjerimet tuaja, por edhe të grupeve të interesit. Kemi qenë pjesëtarë të tryezave të tyre, por edhe do të jemi pjesëtarë të këtyre bisedave. Kaq kisha. Nëse ka diçka tjetër, ekipi teknik është këtu.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera?

(Nuk dëgjohet)

Ne votuam në parim Kodin e Familjes dhe ligjin “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”. Ju lutem, relatoret në bashkëpunim me komisionin, të

organizojnë seancën dëgjimore, të marrin përfundimisht edhe komentet e UNICEF-it dhe të tjerëve dhe të organizojmë në fillim të javës që vjen, shqyrtimin nen për nen të këtij projekti, ku do të jenë të pranishëm edhe përfaqësues nga ministria, por do t'ju sugjeroja që të njoftohen për ditën kur do të zhvillohet seanca dëgjimore. Ndërkohë, çfarë komentesh do të ketë nga grupet e interesit, t'i përcillen paraprakisht ministrisë, që të jetë në dijeni, në mënyrë që të mos gjendemi para të papriturave për diskutimin nen për nen.

E mbyllim këtu për këto dy projektligje.

Faleminderit, zoti Isaraj! Faleminderit, zonja Treska! Faleminderit gjithë të tjerëve!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin numër 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH-së” i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

z. Erion Manhasa - Drejtor i Inspektimit dhe Dialogut Social, Ministria e Mirëqënies Sociale, Rinisë

zj. Kledia Mazniku - Drejtore e Sherbimeve Juridike

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin numër 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH-së” i ndryshuar”.

Ministria, për Kodin e Punës?

Ne e kemi mbyllur diskutimin, e kemi parë e kemi riparë, tani është momenti i votimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Para votimit në tërësi, a ka ndonjë diskutim tjetër shtesë?

Erion Manohasa – Kemi diçka për nenin 40 të ligjit aktual.

Në mbledhjen e fundit, ne bëmë një propozim për një riformulim të nenit 40 dhe prisnim edhe propozime për përmirësime nga ana e komisionit. Nuk e di nëse ka?

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e morëm propozimin e sjellë nga përfaqësuesit e ministrisë. Ne mendojmë se formulimi i paragrafit të dytë të nenit 40, ashtu sikurse është në ligj, e përfshin edhe shqetësimin e tyre, madje është më i plotë, sepse në ligjin aktual thuhet: “Kur punimet paraqesim rreziqe të veçanta, punëdhënësit duhet të organizojnë vizita mjekësore për marrjen në punë dhe gjatë saj, në mënyrë periodike, me shpenzimet e tyre”.

Propozimi që sillte përfaqësuesi i ministrisë i kufizonte llojet e punëve të rrezikshme, por, njëkohësisht, kërkonte që vizitat mjekësore të organizoheshin nga mjeku i ndërmarrjes. Ndërkohë, në konsultimin që kemi bërë edhe me standardet, por edhe me ligjin, një e drejtë e fituar nuk mund të hiqet nga Kodi. E para.

E dyta. Mund të ndodhë që personi të ketë nevojë vetëm për vizita mjekësore nga mjeku i ndërmarrjes. Askush nuk e pengon, sepse në ligj nuk thuhet që detyrimsht duhet bërë në spitale, pra lihet e hapur në ligjin ekzistues. Mund të bëhet edhe nga mjeku, por kur ka nevojë për një trajtim të specializuar, atëherë nuk mund ta bëjë një mjek i ndërmarrjes, i cili mund të jetë një mjek i përgjithshëm, por ka nevojë të shkojë në qendrat e specializuara.

Gjithashtu, fakti që këtu parashikohet se shpenzimet i mbulon ndërmarrja, kjo duhet të qëndrojë, sepse tashmë është një e drejtë e fituar. Në propozimin që sillte përfaqësuesi hiqeshin fjalët “me shpenzimet e tyre”.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti...

Erion Manohasa - Në propozim thuhej që të hiqej elementi kur paraqet rreziqe të veçanta, sepse gjatë punës një punëmarrës mund të ketë problematika të ndryshme dhe të mos kufizohet në elementin e marrjes në punë apo të vizitave periodike. Kjo është edhe në frymën e vetë Kodit të Punës dhe të standardeve ndërkombëtare të ILA-s, të cilat nuk flasin në veçanti për rreziqe të veçanta, por flasin për rrezikshmëri të marrëdhënies së punës në vetvete dhe të mund të gjejmë një rrugë ndoshta të mesme, një riformulim, që ne si ministri e kemi propozuar, ku të lihet elementi i mjekut të ndërmarrjes, i cili edhe në ligjin “Për sigurimin e shtetasve në punë” dhe në të gjitha aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, si dhe në nenin 130 të Kodit të Punës, ku parashikohet një lloj ndarjeje e funksioneve midis mjekut të ndërmarrjes dhe atij të lagjes. Po të shihet, ne kemi ndryshuar edhe numrin e punëmarrësve për çdo subjekt, të cilët duhet të kenë një mjek ndërmarrjeje dhe kohën në të cilën ai duhet të punësohet, me kohë *part time* apo *full time*. Kështu që propozimi ynë është një rrugë e mesme midis propozimit të parë dhe kundërshtive të komisionit, për sa i përket riformulimit.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Edhe zonja Hysi është dakord me propozimin tuaj.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Më fal, te neni 131 nuk thuhet për mjekun e punëdhënësit, por: “Punëmarrësi është i detyruar t’i nënshtrohet ekzaminimit nga një mjek tjetër, i caktuar nga punëdhënësi”, pra duhet të kemi pak kujdes. Nuk i mohohet punëmarrësit e drejta që të mund të ketë edhe një mjek tjetër, përveç mjekut të firmës, kompanisë private apo të ndërmarrjes, sepse jo në çdo rast mjeku i ndërmarrjes është specialist.

Lidhur me atë që thoni për rreziqet e veçanta, unë jam dakord që ta riformulojmë, por rrezik të veçantë ka dhe një fason me mastiçin, që bën këpucë. Pra, rreziqe të veçanta nuk janë vetëm ato që kanë kompani ndërtimi dhe kantiere të rënda. Nuk duhet lënë jashtë mbrojtjes asnjë kategori punëmarrësi në asnjë vend, pavarësisht natyrës së punës. Prandaj për këtë të parën jam dakord, për të dytën nuk duhet të heqim fjalët “shpenzimet i paguan punëdhënësi”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Bini dakord? Dakord.

Zoti Halimi, keni fjalën.

Eduard Halimi – Lidhur me Kodin e Punës ne kemi ngritur shqetësimin, edhe në seancat e tjera që është shqyrtuar ky Kod. Ne kemi abstenuar në parim dhe kemi votuar kundër pastaj në votimin nen për nen për shkak, sepse në projektligjin “Për ndryshimet në Kodin të Punës”, ka një regres për sa u përket të drejtave të punësuarve, pasi i është hequr e drejta gjykatës për të vendosur

kthimin në punë të atyre subjekteve, të atyre të punësuarve, të cilët nuk i prek ligji “Për shërbimin civil”. Gjatë seancave të mëparshme i kërkuam edhe qeverisë, ju kërkuam edhe juve, kolegë, që ky qëndrim të ndryshohet, sepse kërkesa e opozitës është racionale. Ne kërkojmë që gjykata të jetë ajo që të ketë diskrecionin për të vendosur nëse një i punësuar duhet të kthehet ose jo. Ndërsa ju e bëtë vetëm për ata që janë në ligjin “Për shërbimin civil”, duke i referuar tek Gjykata Administrative “Për ligjin e shërbimit civil”. Ndërkohë që ka një numër të madh punonjësish të tjerë, të cilët nuk i përfshin ky ligj. Kodi i mëparshëm e ka pasur dhe Kodit që po ndryshohet tani i hiqet. Shpjegimi që u dha nga qeveria në një nga seancat ishte: “Meqenëse jemi në kohë krize, u tha, duhet të marrim masa të tilla radikale”, për ne nuk është racional dhe nuk është i pranueshëm. Për këtë arsye, në qoftë se nuk ka reflektim lidhur me çështjen e dhënies së diskrecionit të gjykatës për t’u shprehur dhe për t’i rikthyer në vendin e punës, si dhe nuk ka një përgjigje pozitive për të ekzekutuar të gjitha vendimet e gjykatave, për të rikthyer në punë opozita e quan si një shenjë të mosarritjes së kompromisit dhe do të votojë kundër.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi, për ta mbyllur diskutimin, pasi ramë dakord, për nenin 40 për një riformulim, për të votuar në tërësi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Më vjen keq që kolegu nuk e ka lexuar variantin integral që ka ardhur sot për votim. Konkretisht, tre pikat që ishin lënë për diskutim: neni 40, neni 155 dhe propozimi i kolegut Fino për anëtarësimin e këshillit konsultativ trepalësh është reflektuar.

Konkretisht, në nenin 68, që ndryshon neni 155, është lënë “Për punëmarrësin në administratën publike dhe kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar ta zbatojë këtë vendim”. Unë habitem pse ju duhet të votoni kundër kësaj gjëje. Gjithashtu, edhe për nenin “Për këshillin konsultativ “ shqetësimi që ngriti zoti Fino është marrë në konsideratë.

Lidhur me të drejtat, ky ligj u ofron më shumë të drejta dhe mbrojtje punëmarrëse sesa më parë.

Eduard Halimi – Zonjë, unë kam respekt për ju dhe i lexoj gjërat para se të vij këtu. Unë ngrita shqetësimin, zonjë, që ju, pas 20 vjetësh, i hiqni të drejtën gjykatës që të shprehet për largimet nga detyra.

Fatmir Xhafaj – Nuk e kemi hequr.

Eduard Halimi – E keni hequr, e keni ndryshuar Kodin.

Fatmir Xhafaj – Po, të them se ngeli siç është.

Eduard Halimi – Për këtë rast ne kemi votuar kundër.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë do ishte mirë ta kishit rilexuar, u rikthye siç ishte, po ua themi, e tha dhe zonja, ishin 3 pikat. Dakord e keni dhe në *email*, shikojeni tekstin integral.

Kush është pro në tërësi? Kundër? 2 kundër.

Në rregull, faleminderit!

Ju lutem, para se të fillojmë Kodin Penal, është ora 12:00 do t'ju kërkoja sipas vendimit të qeverisë 1 minutë heshtje!

U prehshin në paqe!

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”, është teksti integral.

Kemi lënë për diskutim vetëm nenin 13. Relatorja, në bashkëpunim me zotin Manja, zotin Muçmataj, duke reflektuar vërejtjet, sugjerimet e ngritura nga kolegët gjatë debatit që u bë për këtë nen, edhe në konsultimet me organizatat e biznesit, në mënyrë të veçantë me Shoqatën e Tregtarëve, me qeverinë kanë rënë dakord që të ketë një riformulim të nenit 13. Riformulimi i nenit 13 është i tillë, pas nenit 180 shtohet neni 180/a me këtë përmbajtje: “Moslëshimi i kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore nga personi, i cili ka detyrimin të lëshojë kuponin tatimor, dëftesën ose faturën tatimore kur është marrë më parë masa administrative dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 vit”. Paragrafi i dytë: “Ushtrimi i një aktiviteti tregtar të paligjshëm ose të paregjistruar në organet tatimore të pa pajisur me kasë fiskale, sipas dispozitave ligjore në fuqi, apo dhënia e urdhrave në kundërshtim me ligjin, me qëllim të moslëshimit të kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore, kur është marrë më parë masa administrative dënohet me burgim deri në 3 vjet”. Kjo është përmbajtja e nenit 13, e riformuluar tërësisht, e ndarë me dy paragrafë, edhe me miratimin e qeverisë.

Ka vërejtje, sugjerime?

Po, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi - Zoti Xhafaj, ne qëndrimin tonë në lidhje me këtë ligj e kemi bërë të qartë që në seancat e mëparshme të komisionit. E them që në fillim: Partia Demokratike është totalisht kundër kësaj fryme represive, me të cilën ju po qasni një dështim të administratës suaj. Juve po ju mbyet evazoni në dogana dhe në tatime. Ky nuk është evazion, se jeni thjesht të paaftë, por është evazion, që tolerohet nga instancat më të larta. Për këtë arsye ju, për të mbuluar këtë gropë të madhe, që po ia shkaktoni vetë, në mënyrë kriminale, ekonomisë shqiptare, kërkon që këtë barrë ta kaloni, nëpërmjet akteve represive të qytetarët, të cilët vendosin të bëjnë biznes.

Ne besojmë se kjo qasje represive nuk mund të jetë lufta kundër evazionit. Ne jemi të gjithë, pa diskutim, për ta luftuar evazionin. Instrumentet në Kodin Penal janë të mjaftueshëm. Gjithë kjo që ju kërkon të bëni është e papranueshme. Kështu që, me përjashtim të atyre elementeve, me të cilët herën e kaluar ne ishim dakord, për ti mbështetur propozimet për të luftuar krimin, që vinin nga Prokuroria e Përgjithshme, që janë një interes publik jo një interes thjesht i

Kryeministrit për të rritur represionin mbi bizneset dhe mbi individët, ne jemi kundër kësaj pakete që propozon qeveria dhe që jeni të gatshëm ta votoni sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eduard Halimi – Në fakt, çështja e kuponit tatimor, që nga dita që Kryeministri, e firmosi si një krim në Kodin Penal, pra e parashikoi si një krim në Kodin Penal, duke lënë të vetmen alternativë burgun deri në 3 vjet, u kthye në një debat të madh, e iniciuar nga opozita ditën e parë që Kryeministri e ka firmosur. Ditën e parë që Kryeministri e ka firmosur, kryetari e opozitës ka thënë se kjo kundërvajtje, kjo shkelje ligji, sepse shkelje ligji është normale, duhet të jetë kundërvajtje administrative ose maksimalisht kundërvajtje penale, sepse në gjithë tërësinë e Kodit Penal kishte një disproporcion të madh nga ajo që kishte firmosur Kryeministri me këtë veprim. Jua kam thënë edhe më përpara, ajo që kishte firmosur qeveria ishte: hajduti dënohej më pak sesa ai që nxirrte që lëshonte kuponin tatimor. Hajduti, neni 135 në mos gaboj i Kodit Penal, kishte gjobë deri në 3 vjet, ai që vidhte, ai që nuk e lëshonte kuponin tatimor, nuk dënohej me gjobë, kishte burg deri në 3 vjet. Ndaj, kjo që vjen sot shihet si një reagim racional, si një tërheqje për këtë nen, për nenin që i përket kuponit tatimor.

Në të gjithë Kodin Penal ka dhe raste të tjera kur punëdhënësit apo bizneset kryejnë shkelje të legjislacionit fiskal, pasi dënohen në mënyrë administrative dhe e bëjnë në mënyrë të përsëritur, ky veprim konsiderohet si një kundërvajtje administrative. Në këtë formulim, siç është bërë paragrafi i parë, është një reflektim racional që i përgjigjet ndoshta edhe natyrës në të cilën mund të kryhet një proces. Por nuk duhet të ishte firmosur në atë formë, siç është bërë, siç nuk duhet të jetë bërë, sepse nuk duhet të miratohet, në mënyrë joracionale, tërësia e të gjithë neneve të tjera. Kuponin tatimor ngjalli shqetësimin, sepse i binte mu në ballë logjikës së një shtetari, që nuk ka konceptet. Mos harroni se aty keni dhe nene të tjera, i keni parë ju aty, nenet e tjera, që ne i kemi diskutuar, në të cilët bizneset që mund të kenë elemente të kontrabandës, dënohen më shumë se trafikantët, më shumë se atë që mbjellin kanabis. Po të mbjellës kanabis, dënohesh deri në 7 vjet, po të jesh biznesmen dhe të kesh marrë një arkë me verë më tepër apo një stekë me cigare, dënohesh 5-10 vjet. Pra, këto janë joracionale dhe në disproporcion të plotë. Për këtë nen, për paragrafin e parë shikohet një tërheqje...

Fatmir Xhafaj – Do ta votoni?

Eduard Halimi- Paragrafin e parë të këtij neni do ta votojmë, të dytin jo, për mua.

Fatmir Xhafaj- Megjithatë, duhet të ishit qartësuar me njëri-tjetrin, sepse mbajtët pozicione të ndryshme, por nuk ka problem.

Ka nga kolegët ndonjë gjë tjetër, se dhe opozita reflektoi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kush është dakord me nenin 13, me ndryshimin e bërë? Kundër? 1 kundër.

Kush është dakord në tërësi me ndryshimin e Kodit Penal?

Faleminderit! Kundër? 2 kundër, nga përfaqësuesit e opozitës.

Faleminderit! Mbyllet dhe Kodi Penal!

Besoj se është i qartë edhe për medien riformulimi i nenit 13. E mbyllim këtu.

Gjithë të mirat!

MBLEDHJA MBYLLET